


## INSTRUKSIONE -DEPOZITIM PA KARTË ME KOD UNIK PËR KLIENTËT E BIZNESIT

### 1. Faza e parë në Degën Internet


#### Hapi 1

Klienti hyn në Degën Internet për Bizneset dhe klikon në Menu " **Transaksione pa kartë**". Menu-ja e " **Transaksione pa kartë**" ka dy nën menu " Gjenero Kodin Unik" dhe " Lista e transaksioneve pa kartë".



#### Hapi 2

Për të gjeneruar kodin unik klienti duhet të zgjedhi nënmenu " Gjeneron kodin unik" dritarja në vazhdim do të shfaqet:



*This document is property of BKT and cannot be shared with third parties.  
Ky dokument është në pronësi të BKT-së dhe nuk mund të ndahet me palë të treta.*

Fillimisht klienti duhet të zgjedhi llogarinë në të cilën do të depozitohen fondet (kujdes monedha e llogarisë duhet të jetë e njëjtë me monedhën e shumës që do të depozitohet në ATM, në rast se monedhat janë të ndryshme veprimi në ATM nuk do të kryhet).

### Hapi 3

Në dritaren "Detajet e punonjësit" zgjidhni nga lista emrin e personit që do të kryejë depozitim në ATM. Në list do të shfaqen emrat e punonjësve të subjektit të cilët kanë përfituar pagën në BKT gjatë 2 muajve të fundit, në list do të përfshihet dhe përfaqësuesi ligjor i subjektit. Pasi të zgjidhni emrin e punonjësit/përfaqësuesit ligjor do të plotësohet automatikisht "ID e punonjësit" dhe "Numri i telefonit" (të dy fushat janë të paeditueshme dhe nuk mund të ndryshohen).



**Detajet e punonjësit**

Zgjidh punonjësin ★

Ju lutemi zgjidhni

ID e punonjësit

Numri i telefonit ★

Numri i telefonit të punonjësit tek i cili do ti dërgohet kodi unik duhet të jetë i saktë, për të përditësuar numrin e telefonit, punonjësi duhet të paraqitet në një nga sportelet e Bankës!

### Kujdes!

Numri i telefonit të punonjësit tek i cili do ti dërgohet kodi unik duhet të jetë i saktë, për të përditësuar numrin e telefonit, punonjësi duhet të paraqitet në një nga sportelet e Bankës!

### Hapi 4

Në dritaren "Detajet e depozitës" zgjidhni nga lista një nga opsionet si në vazhdim.

- Zgjidhni ATM ku do të depozitoni para - klienti duhet të zgjedhi nga lista ATM-në ku do të depozitohen fondet (nëse nuk dëshiron të zgjedhi një ATM specifike mund të klikoj opsionin *ALL-të gjitha ATM*).
- Zgjidhni kohën e vlefshmërisë së kodit unik (në orë) - nga lista zgjidhni kohën e validimit të kodit unik. Koha minimale është 1 orë dhe maksimumi 72 orë.



**Detajet e depozitës**

Zgjidhni ATM ku do të depozitoni para ★

Ju lutemi zgjidhni

Zgjidhni kohën e vlefshmërisë së kodit unik (orë) ★

Ju lutemi zgjidhni

Burimi i të ardhurave ★

Ju lutemi zgjidhni

Nëse burimi i të ardhurave nuk përkon me asnjë nga opsionet mësipër, për depozitim të fondeve duhet të paraqiteni në një nga degët e BKT-së



**Detajet e depozitës**

Zgjidhni ATM ku do të depozitoni para ★

Ju lutemi zgjidhni

- ALL
- BKT ATM S.DELVINA
- BKT ATM TWIN TOWER
- BKT KINEMA SHERATON
- BKT ATM FINTECH
- BKT ATM RR.KAVAJES

- Zgjidhni burimin e të ardhurave nga lista që shfaqet "Të ardhura nga Biznesi, Shitje Asetesh, Investim nga Ortaku, Hua".

### Kujdes!

Nëse burimi i të ardhurave nuk përkon me asnjë nga opsionet mësipër, për depozitimin e fondeve duhet të paraqiteni në një nga degët e BKT-së.


Pasi të keni plotësuar të dhënat klikoni "Vazhdo".

### Hapi 4

Kontrolloni detajet e kodit unik nëse informacioni është i rregullt klicko "Vazhdo" për të gjeneruar kodin unik.

## Hapi 5

Mesazi i gjenerimit me sukses të kodit unik do të shfaqet si në vazhdim:




Punonjësi/përfaqësuesi ligjor, i cili dot të kryejë depozitimin në ATM, do të marrë të njëjtin format mesazhi me SMS në numrin e tij celular.

## Kujdes!

Për të gjitha llojet e kompanive me të drejta të plota apo me nivele aprovimi, kodi do të gjenerohet automatikisht për të gjithë përdoruesit që kanë të zgjedhur këtë opsion në plotësimet e formularëve. Gjenerimi i kodit unik nuk do të jetë pjesë e procesit me nivele aprovimi. Ndërsa për personat fizikë shtimi i të drejtës do të bëhet automatikisht.

## 2. Nënmenu Lista e transaksioneve pa kartë




Për të kontrolluar kodet unik që keni gjeneruar zgjidhni "Lista e transaksioneve pa kartë" dhe do ju shfaqen statust dhe të dhënat e kodit unik të gjeneruar.



### ➤ Faza e dytë – Depozitimi i fondeve me Kod Unik në ATM

## Hapi 1


Punonjësi paraqitet në ATM ku do të depozitoj fondet e aktivitetit nga biznesi dhe klikon në menunë "Transaksione pa Kartë" dhe më pas opsionin "Depozito me Kod Unik".




## Hapi 2


Në vazhdim do të shfaqet ekrani për plotësimin e kodit unik. Punonjësi/Përfaqësuesi ligjor do të vendosi kodin unik të dërguar në numrin e tij të telefonit në ekranin e ATM-së.







### Hapi 3

Me validimin e kodit unik me sukses, do të kryhet depozitimi i fondeve në hapësirën e përcaktuar në ATM. Me validimin e kartëmonedhave të depozituara, në hapin pasardhës punonjësi/përfaqësuesi ligjor do të konfirmojë shumën e depozituar në ATM në ekranin përmbledhës duke klikuar mbi butonin 



### Hapi 4

Në hapin e fundit përzgjidhet nëse dëshiron të pajiset me faturë fizike ose jo. Për t'u pajisur me faturë punonjësi/përfaqësuesi ligjor klikon mbi butonin  Ose mbi butonin  nëse nuk dëshiron të pajiset me faturë.